



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 99, datë 29.09.2022

PËR

MIRATIMIN E DETAJIMIT DHE PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 104.155.472 LEKË PA TVSH TË MBETUR PA PËRDORUR NGA FONDET E AKORDUARA ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.40, datë 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2.303.173.480 lekë pa tvsh në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, VKB-së Nr.62, datë 16.06.2022 “Për miratimin e ndryshimit të tabelës së detajimit të fondit, bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 09.05.2022 “Për miratimin e detajimit të fondit prej 2’303’173’480 lekë pa tvsh në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë” për shkak të një gabimi material”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit prej 104.155.472 (njëqind e katër milion e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, të mbetur pa përdorur nga fondet e akorduara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.181, datë 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, sipas tabelës së mëposhtme, pjesë përbërëse e këtij vendimi:

Objekti	Vlera e projektit	Vlera e mbikëqyrjes	Vlera e kolaudimit
“Riforcim godine banimi 10-11 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga “Neki Libohova” nr.15, rruga “Abaz Çelkupa” nr.26, kod GIS 24907, 24923”, faza II.	35.445.341 lekë	575.548 lekë	55.698 lekë
Riforcim i godinave pallat me kod GIS 1569, 27348, 27501	67.033,724 lekë	952.941 lekë	92.220 lekë
Totali	102,479,065 lekë	1,528,489 lekë	147,918 lekë
Totali i fondit për t’u përdorur			104,155,472 lekë

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 776/4 prot.

Durrës, më 07.10.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.99 datë 29.09.2022 :

“Për miratimin e detajimit dhe përdorimit të fondit prej 104.155.472 lekë pa TVSH të mbetur pa përdorur nga fondet e akorduara me VKM Nr 181, dt 30.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkirtë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

